AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

Rregullimi i tarifave të sipërmarrësve me FNT ne tregjet me shumice te aksesit broadband dhe në infrastrukturen aktive dhe pasive në rrjete fikse

Dokumenti Perfundimtar

Miratuar me VKD nr.2703, datë 22.12.2016

Tabela e Përmbajtjes

1. Hyrje 4

2. Tarifat me shumice te aksesit në rrjete fikse nën-rregullim dhe ecuria e tyre .6

3. Tarifat benchmark te aksesit ne rrjete fikse.....9

3.1. Tarifat benchmark të aksesit per LLU 9

3.1.1 Tarifat mesatare në vendet e BE të publikuara nga KE 9

3.1.2. Tarifat e aksesit te plote dhe te perbashket ne LLU dhe aksesi ne nen-qark (SLU)..... 10

3.1.3. Tarifat e aksesit ne tubacione 14

4. Rregullimi i tarifave me shumice te aksesit ne infrastrukturen e rrjeteve fikse ne Shqiperi 20

4.1. Alternativat per rregullimin e tarifave 20

4.2. Tarifat per LLU dhe Tuba ne nivel local (Tregu WLA) 24

4.3. Tarifat per aksesin bitstream (Tregu WCA) 27

4.4. Tarifat per Linjat me qira (Tregu WHQA): Albtelecom 28

5. Efektet e pritshme.....29

Aneks 1: Lista e Shkurtimeve të Shteteve 32

Aneks 2: Komentet e keshillimit publik dhe qendrimi i AKEP 33

Lista e Tabelave dhe Figurave

TABELA 1: TARIFAT E AKSESIT NE RRJETIN LOCAL LLU TE ALBTELECOM (2014) 6
TABELA 2: METODA E RREGULLIMIT TE TARIFAVE TE AKSESIT BITSTREAM TE ALBTELECOM (2014) 7
TABELA 3: TARIFAT MUJORE TE AKSESIT BITSTREAM TE ALBTELECOM (TETOR 2016) 8
TABELA 4: TARIFAT E AKSESIT NE RRJETIN LOCAL LLU 11
TABELA 5: TARIFAT E AKSESIT NE TUBACIONE NE RRJETIN ALBTELECOM (2015-2016) 14
TABELA 6: TARIFAT MUJORE TE AKSESIT NE TUBACIONE NE VENDET BE DHE RAJONIT (2016) 15
TABELA 7: TARIFAT MUJORE TE AKSESIT NE TUBACIONE NE VENDET E RAJONIT 18
TABELA 8: TARIFAT ME SHUMICE TE ALBTELECOM PER AKSESIN LLU (2017) 25
TABELA 9: TARIFAT MAKSIMALE TE AKSESIT NE TUBACIONE NE RRJETIN LOKAL TE ALBTELECOM (2017-) 26
TABELA 10: TARIFAT MAKSIMALE MUJORE TE AKSESIT BITSTREAM TE ALBTELECOM (1.07.2017-) 27
TABELA 11: TARIFAT MAKSIMALE TE LINJAVE ME QIRA ME SHUMICE TE ALBTELECOM (1.07.2017-) 28

FIGURA 1: TARIFAT E AKSESIT TE PLOTE NE LLU NË VENDET E BE DHE SHQIPERI (2013 DHE 2016) 10
FIGURA 2: TARIFAT MUJORE TE AKSESIT TE PLOTE NE LLU (2016) 12
FIGURA 3: TARIFAT MUJORE TE AKSESIT TE PERBASHKET NE LLU (2016) 12
FIGURA 4: TARIFAT MUJORE TE AKSESIT TE PLOTE NE SLU (2016) 13
FIGURA 5: TARIFAT MINIMALE MUJORE PER AKES NE TUB 16
FIGURA 6: TARIFAT MAKSIMALE MUJORE PER AKES NE TUB 17
FIGURA 7: SHKALLA E INVESTIMEVE 22

1. Hyrje

AKEP nëpërmjet Vendimit nr.2681, datë 8.06.2016, miratoi nxjerrjen në këshillim publik të dokumentit "*Analizë e tregjeve me shumicë të aksesit broadband ne Internet dhe Linjave me Qira- Keshillim Publik*". Periudha e këshillimit publik ishte 15.06-15.08.2016. Ne perfundim te keshillimit publik, pas marrjes se komenteve te paleve te interesuara, AKEP pergatititi versionin final te dokumentit te analizes se tregut, i cili u miratua nga KD i AKEP me Vendimin Nr.2701, date 22.12.2016. Në dokumentin perfundimtar Analizës së Tregut, AKEP kreu një ri-perkufizim të tregjeve perkatese te lidhura me aksesin broadband të analizuar në vitin 2014, duke marre ne konsiderate rekomandimin e vitit 2014 te KE (2014/710/EU) dhe kushtet e tregut te komunikimeve elektronike ne Shqiperi. Në lidhje me FNT në treg, AKEP me VKD Nr.2702, date 22.12.2016, bazuar ne dokumentin perfundimtar te analizes se tregut percaktoi sipermarresin Albtelecom sipermarres me FNT (dominance individuale) ne:

1. Tregun me shumice te aksesit ne nivel lokal ne vendndodhje fikse (WLA)
2. Tregun me shumice te aksesit ne nivel qendror per produkte te tregut te pergjithshem (WCA)
3. Tregun me shumice te aksesit me cilesi te larte ne vendndodhje fikse (WHQA);

Në lidhje me masat rregulluese, AKEP percaktoi qe Albtelecom të kete detyrime për FNT si mos-diskriminim, transparencë, dhënie aksesi si edhe detyrimin për kontroll dhe rregullim të tarifave të shërbimeve të ofruara prej tij në tregjet përkatës në të cilat percaktohet me status me FNT. Ne lidhje me masen rregulluese te kontrollit te tarifave te sipermarresve te propozuar per status me FNT, në dokumentin e analizës së tregut të nxjerre në këshillim publik AKEP ka sqaruar se do te zhvilloje nje proces te vecante keshillimi publik, ne perputhje me percaktimet e nenit 57 e ne vijim te Ligjit 9918, per te percaktuar metoden e kontrollit te tarifave te sipermarresve me FNT ne keto tregje perkates.

Në përputhje me sqarimin e cituar, AKEP me Vendimin nr.2682, date 7.07.2016, miratoi nxjerrjen në këshillim publik te dokumentit "*Rregullimi i tarifave të sipërmarrësve me FNT ne tregjet me shumice te aksesit broadband dhe në infrastrukturën aktive dhe pasive në rrjete fikse*

– *Këshillim Publik”* për të përcaktuar metodën e rregullimit të tarifave të sipërmarrësve me FNT në tregjet përkatës dhe modalitetet e tjera të rregullimit të këtyre tarifave. Procesi i këshillimit publik të këtij dokumenti perfundoi me date 15 Shtator 2016. Versioni final i këtij dokumenti te nxjerre ne keshillim public miratohet pas miratimit nga KD i AKEP me Vendimet Nr. 2701, date 22.12.2016 dhe Nr.2702, date 22.12.2016 të versionit final të dokumentit të Analizës së Tregut, dhe vendimit per FNT te Alebtelecom, dhe ka reflektuar ndryshimet e kryera ne versionin final te analizes se tregut te nxjerre ne keshillim publik te dokumentit “*Analizë e tregjeve me shumicë të aksesit broadband ne Internet dhe Linjave me Qira-Këshillim Publik*”, si dhe te ketij dokumenti te nxjerre ne keshillim publik.

2. Tarifat me shumice te aksesit në rrjete fikse nën-rregullim dhe ecuria e tyre

Ne baze te versionit final analizes se tregut, "*Analizë e tregjeve me shumicë të aksesit broadband ne Internet dhe Linjave me Qira-Versioni Perfundimtar*", AKEP ka percaktuar qe Albtelecom nder te tjera te vazhdoje të zbatojë detyrimet e vendosura nga AKEP ne dy dokumentat e analizave të tregut të kryera në vitin 2014. Në lidhje me tarifat e shërbimeve të percaktuar qe të jenë nën-rregullim sipas dokumentit final te analizes se tregut, AKEP në këtë seksion paraqet ecurinë e tyre nga analiza e fundit si dhe të tarifave të aksesit në tubacione për Albtelecom. Ky seksion është bazuar në informacionin e dokumentit të analizës së tregut, Seksioni II.1.

Tarifat e Albtelecom për LLU

Ne lidhje me tarifat per LLU, AKEP në analizën e tregut 2014 vendosi që Albtelecom te aplikoje tarifat e miratuara me VKD nr.1365, date 13.04.2011, duke saktesuar qe per linjat e aksesuara ne MSAN per LLU, Albtelecom te aplikoje tarifat perkatese te aksesit (te plote dhe te perbashket) në **nën-rrjetin lokal.** Metoda e zgjedhur ishte aplikimi i tarifave maksimale, sipas rezultatave te modelit te kostove BULRAIC ne vitin 2010.

Tabela 1: Tarifat e aksesit ne rrjetin local LLU te Albtelecom (2014)

Shërbimi	Tarifa (Lekë)	Njësia
Pagesa mujore për LLU		**Paguhen çdo muaj**
Akses i plote në rrjetin lokal (full unbundled access LLU)	**801**	[per linjë]
Akes i perbashket në rrjetin lokal (shared access LLU)	**468**	[per linjë]
Akses i plote në nën-rrjetin lokal	**678**	[per linjë]
Akes i perbashket në nën rrjetin lokal	**407**	[per linjë]
Pagesa instalimi për LLU		**Paguhet vetëm një**

		herë
Instalimi I aksesit te plote ne rrjetin lokal	**1 686**	[per linjë]
Instalimi I aksesit te perbashket në rrjetin lokal të hapur	**2 452**	[per linjë]

Shenim: Tarifat e mësipërme nuk përfshijnë TVSH

Aksesi bitstream

Në lidhje me aksesin bitstream, AKEP në analizën e tregut 2014 vendosi që tarifat e aplikuara nga Albtelecom për këtë shërbim ne nivel ATM/Ethernet dhe ne nivel IP, pra ne layer 2 dhe 3 te rrjetit NGN/NGA, të rregullohen me metodën "retail minus":

Tabela 2: Metoda e rregullimit te tarifave te aksesit bitstream te Albtelecom (2014)

Niveli i aksesit	Cmimi Maksimal
Ne nivel ATM/Ethernet;	Tarifa Retail - 50%
Ne nivel IP	Tarifa Retail - 30%

Shenim: Tarifa retail me pakice pa TVSH

AKEP njekohesisht vendosi qe tarifa per akses bitsream nuk mund te jete me i lire se cmimi per akses ne LLU. Ne vijim te argumentit ne pjesen e analizes per LLU, cmimi (tarifa mujore) per akses bitsteram nuk mund te jete me i ulet se 407 lek/muaj.

Albtelecom pas vendimeve te AKEP ne vitin 2014 ka publikuar oferten reference te aksesit bitstream dhe ka kryer 2 here rishikim te tarifave duke bere reduktime deri ne 90% te tyre krahasuar me tarifat fillestare. Per sherbimet e aksesit bitstream, Albtelecom ka lidhur marrveshje me 4 operatore ne 2014-2015. Pas periudhes se keshillimit publik, Albtelecom ne Shtator 2016 ka njoftuar nje reduktim tjeter te tarifave te aksesit bitstream, me tarifat e reja qe hyjne ne fuqi me 1 Tetor 2016. Reduktimet e muajit Tetor 2016 variojne nga 7% per aksesin bitstream per shpejtesi 6 Mbps ne 17% per aksesin bitstream me shpejtesi 12 dhe 16 Mbps, dhe aplikohen per aksesin ne Ethernet dhe IP, per me pak se 100 porta dhe mbi 100 porta. Per sherbimet e aksesit bitstream, Albtelecom ka lidhur marrveshje me 4 operatore ne 2014-2015. Nga te dhenat rezulton se ne vitin 2014 Albtelecom ka dhene akses bitstream operatoreve te tjere per lidhje me 597 kliente, ndersa deri ne fund te 2015 per 1981 kliente. Tarifat aktuale te aplikuara nga Albtelecom jane dhene ne tabelen e meposhteme.

Tabela 3: Tarifat mujore te aksesit bitstream te Albtelecom (Tetor 2016)

	Opsioni 1: Bitstream ne Ethernet		Opsioni 2: Bitstream ne IP	
Shpejtesia Download	deri 100 porta	>100 porta	deri 100 porta	>100 porta
2 Mbps	468	421	549	494
4 Mbps	623	560	731	658
6 Mbps	766	690	900	810
8 Mbps	1,020	920	1,200	1,080
10 Mbps	1,100	990	1,292	1,163
12Mbps	1,213	1,090	1,425	1,283
16 Mbps	1,395	1,260	1,640	1,470

Shenim: Tarifat ne Lek pa TVSH

Linjat me qira

Ne lidhje me rregullimin e tarifave per sherbimet e aksesit ne Ethernet ne rrjetin NGN dhe rrjet tradicional, AKEP percaktoi si detyrim per Albtelecom qe tarifat me shumice duhet te jene me te lira se tarifat e sherbimeve perkatese me pakice. Tarifat e Albtelecom per kapacitetet me qira Ethernet ne rrjet tradicional dhe Ethernet ne NGN duhet:

- Te mos jene me te larta se tarifat e tabeles se mesiperme;
- Te jene te pakten 20% me te lira se tarifat sherbimeve respektive me pakice.

Ne permbushje te detyrimeve rregullatore per transparence dhe mos-diskriminim Albtelecom ne Korrik 2015 perditesoi Oferten Reference, per tarifat e sherbimit te aksesit te linjave me qira, perditesim ky i cili konsistoi ne nje reduktim te ndjeshem me 70%-90% te tarifave per keto sherbime. Megjithe reduktimet e tarifave edhe per keto sherbime ka pasur interes te ulet nga ana e operatoreve, dhe Albtelecom ka lidhur vetem nje marrveshje me Abcom ne vitin 2015, per kapacitet transmetimi SDH 2xSTM1 dhe 1xE1. Nderkohe interesi me i madh per kapacitete transmetimi rezulton se eshte ne kuader te linjave te interkoneksionit, ku Albtelecom ka dhene kapacitete te linjave me qira per 23 operatore.

3. Tarifat benchmark te aksesit ne rrjete fikse

Ky kapitull permban te dhena mbi nivelin e tarifave me shumice te aksesit ne rrjete fikse per LLU dhe tubacione, ne vendet e BE dhe rajonit, si dhe nje krahasim te nivelit mestar te tyre me tarifat aktuale te ketyre sherbimeve ne Shqiperi. Për sa i përket nivelit të tarifave mesatare të aplikuara në vendet e BE dhe në rajon, AKEP ka grumbulluar informacion duke i'u referuar burimeve të mëposhtme:

- Të dhënat e Komisionit Europian të publikuara për Axhendën Dixhitale të BE[1] (Telecom sector);
- Të dhëna të publikuara nga Cullen International në lidhje me tarifat me shumice te aksesit ne rrjete fikse

3.1. Tarifat benchmark të aksesit per LLU

3.1.1 Tarifat mesatare në vendet e BE të publikuara nga KE

Të dhënat më të fundit të publikuara nga KE në lidhje me tarifat aksesit ne rrjete fikse, permbajne te dhena te tarifave me pakice te aksesit broadband (te referuara ne dokumentin "*Analizë e tregjeve me shumicë të aksesit broadband ne Internet dhe Linjave me Qira-Këshillim Publik*") si dhe te dhena per aksesin ne LLU. Ne lidhje me tarifat per LLU, te dhenat me te fundit te publikuara nga KE i referohen 28 vendeve anëtare të BE per vitin 2013. Tarifa per LLU perfshin pajtimin mujore per aksesin e plote LLU[2], duke i shtuar dhe 1/36 e tarifes se instalimit. Keto te dhena se bashku me tarifen aktuale te aksesit te plote LLU dhe aksesin e plote LLU ne nen-qark (Sub-loop) te Albtelecom (duke i shtuar 1/36 e tarifes se instalimit) paraqiten ne Figurë 1, më poshtë.

[1] https://ec.europa.eu/digital-single-market/download-data

[2] Aksesi i plote LLU (Full LLU) eshte rasti kur operatori perfitues merr nga operatori incumbent te gjithe linjen e bakrit nga MDF deri ne banesen e pajtimtarit per te ofruar akses broadband dhe telefoni, ndersa me aksesin e ndare (shared LLU) operatori perfitues ka akses ne linjen e bakrit vetem per sherbimin akses broadabdn ndersa telefonia ofrohet nga operatori incumbent.

Figura 1: Tarifat e aksesit te plote ne LLU në vendet e BE dhe Shqiperi (2013 dhe 2016)



Burimi: EC Digital Agenda dhe AKEP.

Tarifa mesatare në vendet e BE në 2013 per aksesin e plote LLU ishte 9.36 euro/muaj, që përbën një rënie shume te vogel me 1% nga tarifa mesatare prej 9.5 euro/muaj në vitin 2012. Tarifat ne vendet BE variojne nga 5.28 euro/muaj ne Lituani ne 15.73 euro/muaj ne Finlande. Tarifat e Albtelecom per aksesin e plote LLU (ne qark dhe nen-qark local) jane 35-45% me te uleta se niveli mesatar i BE. Tarifat e Albtelecom jane te krahasueshme me ato te 5 vendeve te BE qe kane tarifen me te ulet dhe nen nivelin 6 euro/muaj.

3.1.2. Tarifat e aksesit te plote dhe te perbashket ne LLU dhe aksesi ne nen-qark (SLU)

Informacioni i dhene ne tabelen e meposhteme eshte marre nga Cullen International dhe eshte me i plote se informacioni i publikuar nga KE i referuar me siper, pasi ai permban te dhena per tarifat edhe per llojet e tjera te aksesit ne rrjetet fikse, si aksesi i perbashket LLU dhe aksesi LLU ne nen-qark, si dhe perfshin edhe informacion nga vende te rajonit qe nuk jane vende anetare te BE, por me zhvillim dhe kushte ekonomike me te ngjashme me Shqiperine.

Tabela 4: Tarifat e aksesit ne rrjetin local LLU

	Full LLU	Shared LLU	Full SLU	Raporti Full SLU/Full LLU	Raporti Shared LLU/Full LLU
AT	5.87	2.94	4.55	78%	50%
BE	8.03	0.89		0%	11%
BG	7.41	2.51	7.41	100%	34%
CH	11.59		9.58	83%	0%
CY	8.51	1.54	5.45	64%	18%
CZ	6.47	0.96	6.36	98%	15%
DE	10.19	1.78	6.79	67%	17%
DK	7.72	3.86	6.71	87%	50%
EE	5.20	5.20	5.20	100%	100%
ES	8.60	1.30		0%	15%
FI	12.80	7.00		0%	55%
FR	9.10	1.77	9.10	100%	19%
GR	7.61	1.51	5.27	69%	20%
HR	5.73	2.20	4.69	82%	38%
HU	5.74	1.80	3.78	66%	31%
IE	9.91	0.77	9.03	91%	8%
IT	8.68	0.86	5.79	67%	10%
LT	4.92	3.89	4.92	100%	79%
LU	9.47		6.31	67%	0%
LV	8.34	4.79		0%	57%
MK	3.41	1.61		0%	47%
MT	9.37	1.87	6.60	70%	20%
NL	7.92	0.11			1%
NO	8.92	5.14	8.92	100%	58%
PL	5.04	1.33	3.84	76%	26%
PT	8.99	2.51	8.99	100%	28%
RO	6.02	1.11	6.02	100%	18%
SE	10.26	4.00	8.33	81%	39%
SI	7.89	3.19	7.89	100%	40%
SK	4.20	1.33	3.00	71%	32%
TR	4.50	1.69		0%	38%
UK	9.48	0.27	10.16	107%	3%
AVG	**7.75**	**2.32**	**6.59**	**85%**	**30%**
AL	5.72	3.34	4.84	85%	58%
Ndryshimi	**-26%**	**44%**	**-26%**	**0%**	**28%**

Burimi: Cullen International (Qershor 2016) dhe AKEP

Figurat e meposhteme paraqesin ne menyre grafike vlerat e tarifave të aksesit ne qarkun e hapur local, per akses te plote LLU (Full LLU), akses i perbashket (Shared LLU) dhe akses i plote ne

nen-qarkun local (Full SLU). Tarifat jane ne Euro pa TVSH. Grafiket jane ndertuar bazuar ne informacionin e tabeles se mesiperme te Cullen International.

Figura 2: Tarifat mujore te aksesit te plote ne LLU (2016)



Figura 3: Tarifat mujore te aksesit te perbashket ne LLU (2016)



Figura 4: Tarifat mujore te aksesit te plote ne SLU (2016)



Burimi: Cullen International dhe AKEP

Krahasimi i tarifave per aksesin LLU me siper tregon se:

- Tarifat mesatare per aksesin ne LLU jane:
    - 7.75 euro/muaj per aksesin e plote ne Full LLU
    - 2.32 euro/muaj per aksesin e perbashket (shared LLU)
    - 6.59 euro/muaj per aksesin e plote ne SLU (nen-qark)
- Tarifat e Albtelecom per aksesin e plote ne qarkun dhe nen-qarkun local jane 26% me te uleta e mesatarja e vendeve europiane;
- Tarifa e Albtelecom per aksesin e perbashket ne qarkun local (shared LLU) eshte 44% me e larte se mesatarja e vendeve europiane.
- Raporti i tarifes se aksesit te plote ne nenqark (SLU) me tarifen e aksesit Full LLU te Albtelecom eshte 85% sa edhe mesatarja e vendeve europiane;
- Raporti i tarifes se aksesit te te perbashket (Shared LLU) me tarifen e aksesit Full LLU te Albtelecom eshte 58% krahasuar me 30% qe eshte niveli mesatar i ketij raporti ne vendet europiane;

AKEP ne dokumentin e analizes se tregut te telefonise fikse ne vitin 2015 ka kryer krahasimin e tarifave me pakice te pajtimit mujor te Albtelecom dhe ne vendet e BE dhe rajonit, ku vihet re se tarifa e pajtimit mujor 700 lek per kategorine familjare standarde e Albtelecom eshte shume me e ulet se e vendeve te BE dhe me e uleta ne rajon.

3.1.3. Tarifat e aksesit ne tubacione

Tabela e meposhteme paraqet tarifat e aplikuara nga Albtelecom per akses ne tubacione apo perdorim te perbashket te tubacioneve te rrjetit te Albtelecom. Ne dokumentin e nxjerre ne keshillim publik, AKEP paraqiti informacion per tarifat per vendosjen e nje kablli me diameter 20 mm ne tub me diameter 100 mm. Ne vijim te komenteve te keshillimit publik si dhe informacionit me te fundit te marre nga Albtelecom (shkresa e Albtelecom me Nr.8005 Prot., date 27.09.2016, njoftim i derguar operatoreve dhe AKEP per tarifat e reja te perdorimit te infrastruktures se lire ne tuba), AKEP ka perditesuar informacionin per tarifat e aplikuara nga Albtelecom, sipas tabeles se meposhteme. Tabela ne dokumentin e keshillimit publik kishte vetem tarifat per vendosjen e nje kablli me diameter 20 mm te operatorit perfitues ne tub me diameter 100 mm te Albtelecom, ndersa tabela e re permban tarifat sipas tre kategorive te diametrave te tubave.

Tabela 5: Tarifat e aksesit ne tubacione ne rrjetin Albtelecom (2015-2016)

		Tarife Fillestare (Euro/km)	Tarifa Mujore (euro/km)							
			Deri me 30.09.2015	1.10.2015			1.10.2016			Ndryshimi ne %
	Distanca (Km)	Diametri (mm)	20 mm	deri ne 10 mm+0.5	>10-20 mm+0.5	>20-30 mm+0.5	deri ne 10	10-20 mm+0.5	20-30 mm+0.5	20 mm
D1	<0.2	100	200	180	190	220	**80**	**90**	**100**	**-55%**
D2	0.2-5	80	160	120	145	179	**60**	**73**	**90**	**-54%**
D3	5-20	80	150	109	136	170	**55**	**68**	**85**	**-55%**
D4	20-40	80	140	104	128	160	**52**	**64**	**80**	**-54%**
D5	40-80	80	130	96	120	144	**48**	**60**	**72**	**-54%**
D6	80-160	80	120	88	112	136	**44**	**56**	**68**	**-53%**
D7	160-300	80	110	80	99	120	**40**	**50**	**60**	**-55%**
D8	>300	80	100	64	92	104	**36**	**46**	**52**	**-54%**

Shenim: Tarifat ne Euro pa TVSH

Nga informacioni i derguar nga Albtelecom per tarifat e tubave mund te vihet re se ne Tetor 2015 tarifat jane reduktuar me 5-10 % ne krahasim me tarifat e meparshme. Nderkohe reduktimi i kryer nga Albtelecom ne Tetor 2016 eshte shume i ndjeshem pasi tarifat e perdorimit te tubave reduktohen kryesisht me 50% (reduktimi varion nga 44% ne 56% dhe shumica kane 50% reduktim) ne krahasim me nivelin e Tetor 2015. Per kabllot 20 mm reduktimi i tarifes eshte 53-55% ne krahasim me Shtator 2015.

Me qellim krahasimin e tarifave te aplikuara ne Shqiperi per tubacionet me vendet e tjera, AKEP ka marre informacion nga Cullen International. Nga informacionet e marra rezulton se:

1. Detyrimi për të dhënë akses në tuba eshte vendosur kryesisht si pjese e detyrimeve ne tregun nr.4 (rekomandimi i 2007 te KE), d.m.th ne aksesin fizik ne infrastrukture te rrjeteve fikse, perfshire LLU, ne rrjetin lokal te operatorit incumbent deri në pikën e hyrjes në ndërtesë (up to the building entry point)
2. Informacioni për tarifat i referohet aksesit në tubacione në pjesën e rrjetit local pra nuk përfshihen tarifat për tuba në rrjet kryesor dhe në shumicën e rasteve janë tarifat të publikuara në ofertën referencë të operatorit incumbent;
3. Tarifat shprehen në varësi të diametrit të tubit dhe/ose në varësi të sipërfaqes së prerjes tërthore të kabllit/tubit, si dhe në disa raste tarifat janë në varësi të vendndodhjes gjeografike të tubit.
4. Në shumë raste aplikohen tarifa one-off për procesimin e kërkesës dhe planin teknik
5. Një factor i rëndësihëm për stimulimin e përdorimit të përbashkët të tubave është regjistri i infrastrukturës (ATLASI).

Informacioni i permbledhur per tarifat mujore te aksesit ne tubacione në vendet evropiane paraqitet ne tabelen dhe figurat e meposhteme. Tarifat janë në euro/km në muaj. Tarifa minimale i referohet kryesisht tubave me diametër të vogël sipas sqarimeve në dy kolonat e fundit.

Tabela 6: Tarifat mujore te aksesit ne tubacione ne vendet BE dhe rajonit (2016)

Shteti	Minimum monthly fee	Maximum Monthly fee	Min Diameter (mm)	Max Diameter (mm)
AT	850.00	850.00		
BG	25.56	107.37	20	40
CH	132.30	132.30		
CZ	59.17	554.73	40/33 mm	100-120 mm
DE	90.00	90.00	25	
DK	207.76	245.29		
EE	48.00	48.00	30 (tub 100mm i ndare ne 6 seksione me 30mm)	30 (tub 100mm i ndare nw 6 seksione me 30mm)
ES	62.00	62.00	40	40
ES 2	8.00	18.00	per cm2 ne tub 110 mm	per cm2 ne tub 63 mm
FI	150.00	300.00	zona 3	zona1
FR	21.00	21.00	per CM2 ne segmentin feeder	per cm2 ne segmentin terminues
GR	120.00	120.00		
HR	24.81	152.03	3-16mm	63-110 mm
HU	76.30	76.30		
LT	27.00	27.00		
LU	130.00	130.00		
LV	74.96	74.96		
MK	29.86	77.00	10	40
NO	115.47	829.26	Rurale	City centre
PT	7.50	10.60	ne cm2 zona te tjera	ne cm2 ne Lisbon dhe Porto
SI	266.54	266.54		

SK	922.00	1,900.00	
TR	39.42	60.36	per cm2 ne tub >29mm zone jo metropol apo city centre / per cm2 per dimater >29mm ne zone metropol
UK	40.02	90.87	
AVG ALL	**153.03**	**270.68**	Mesatarja e te gjitha vendeve ne tabele (pa ES 2)
AVG no Outliers	**90.48**	**121.18**	Mesatarja e te gjitha vendeve pa qelizat me hije gri dhe font te kuq
AVG Region	**39.19**	**94.61**	Mesatarja e vendeve me hije te verdhe
AVG cm2	**12.17**	**16.53**	Mesatarja e vendeve me tarifa per cm2, me font te kuq
AVG Cm2 20 mm	**48.67**	**66.13**	Mesatarja e vendeve me tarifa per cm2 shumezuar me 4
AVG Region 20-40	**67.04**	**67.04**	Mesatarja e tarifave te Maqedonise, Kroacise dheTurqise per tuba 20-40 mm
Albtelecom 20 mm (31.09.2015)	**100.00**	**200.00**	
Albtelecom 20 mm (1.10.2016)	**46.00**	**90.00**	

Burimi: Cullen International Qershor 2016 dhe AKEP

Sic mund te vihet re nga tabela dhe nga grafiket e meposhtem, niveli i tarifave ka diapazon shumë të madh dhe mënyra e tarifimit ka variacione të mëdha dhe eshte komplekse. Meqenese kostot e ndertimit te infrastruktures se tubacioneve (dhe rrjedhimisht tarifes se aksesit per perdorim te perbashket) varen ne mase te madhe nga kostot e puneve civile, eshte e arsyeshme qe ne krahasimin e tarifave te merret ne konsiderate edhe mesatarja e vendeve te rajonit. Njekohesisht ne tabele tarifat e paraqitura per disa vende jane te shprehura ne euro per km dhe cm^2, praktike tarifimi e cila perdoret kryesisht per rastet kur ne nje tub bashkevendosen disa kabllo (te nje apo disa operatoreve) me diameter me te vogel se i tubit.

Figura 5: Tarifat minimale mujore per akes ne tub



Burimi: Cullen International (Qershor 2016) dhe AKEP

Figura 6: Tarifat maksimale mujore per akes ne tub



Burimi: Cullen International Qershor 2016 dhe AKEP

Bazuar ne te dhenat e mesiperme AKEP ne tabele ka perfshire tarifat mesatare si me poshte:

1. AVG ALL: Tarifa mesatare te te gjithave vendeve te paraqitura ne tabele
2. AVG no Outliers: Tarifa mesatare e te gjithave vendeve te paraqitura ne tabele pa vendet qe kane tarifa qe jane dukshem shume te larta si Austria, Cekia, Norvegjia dhe Sllovakia (te evidentuara me kolona te kuqe ne grafiket e mesiperm) dhe vendet qe kane tarifat te shprehuara ne km dhe cm2 (Franca, Portugalia dhe Spanja (ES2)).
3. AVG Region: Tarifa mesatare e Maqedonise, Kroacise, Bullgarise, Turqise dhe Hungarise.
4. AVG cm2: Tarifa mesatare (euro per cm2 dhe km) e aksesit ne tubacione e Frances, Portugalise dhe Spanjes (ES2)
5. AVG cm2 20 mm: Tarifa mesatare ne euro per cm2 dhe km (pika 4 me siper) shumezuar me 4, per te llogaritur tarifen per nje kabell 20 mm. Eshte perdorur koeficenti 4 si diametri ne cm ne katror dhe jo siperfaqja e prerjes terthore te kabllit (πr^2) per te lehuar per siperfaqe te lire ne tub.
6. AVG Region 20-40 mm: Tarifa mestare e aksesit ne tuba 20-40 mm e aplikuar ne Maqedoni, Kroaci dhe Turqi.

Tabela e meposhteme paraqet nje informacion me te detajuar te tarifave te aksesit ne tubacione te aplikuar ne vendet e rajonit, ne te cilat AKEP ka shtuar edhe informacion te marre kohet e fundit per Malin e Zi.

Tabela 7: Tarifat mujore te aksesit ne tubacione ne vendet e rajonit

	Diametri i Tubit	Tarifa Mujore (Euro/km)
Kroacia	3-16 mm	26
	20-40 mm	46
	50 mm	133
	63-110 mm	158
Maqedonia	5 mm	20
		29
	10 mm	29
	32 mm	61
	40 mm	77
Turqia	29 mm	60
		92
Mali i Zi	20mm	30
	40 mm	81
AVG Region 1	20-40 mm	64
AVG Region 2	20 mm	49
AVG Region 3	40 mm	74
Albtelecom	>10 – 20 mm	46-73
	>20-30 mm	52-90

Nga te dhenat e tabeles dhe tarifat e aplikuara nga Albtelecom vihet re se:

1. Tarifat ne disa vende jane shume me te larta se mesatarja dhe ne disa vende jane te shprehura edhe per cm2, dhe ne kete menyre me e pershtashme eshte krahasimi me AVG No Outliers se sa me AVG ALL.

2. Tarifat e Albtelecom deri ne vitin 2015 fillojne me nivelin 190-200 euro/km ne muaj per nje kabell me diameter 20 mm per 1000 metrat e para dhe me pas pershkallezohen duke u reduktuar deri ne 92-100 euro/km per distancat mbi 300 km.

3. Tarifat e Albtelecom per kabllo 20 mm deri ne Shtator 2016 ishin me te larta se mesatarja e te gjitha vendeve AVG no Ouliers (ku perfshihen edhe vende me kosto te puneve civile disa here me te larta se ne Shqiperi) dhe disa here me te larta se sa tarifat ne vendet e rajonit per akses ne tuba 20-40 mm (67 Euro/km).

4. Tarifat e Albtelcom kane pesuar reduktim me rreth 50% ne Tetor 2016 dhe per tarifa e Albtelecom per kabllo 20 mm eshte me e ulet se mesatarja e te gjithave vendeve AVG no Outliers dhe eshte e perfaert me mesataren e rajonit.

Krahasimi i mesiperm tregoi se tarifat e Albtelecom per aksesin ne tubacione ishin shume me te larta se vendet e rajonit, deri ne Shtator 2016. Me reduktimin e ndjeshem te tarifave ne Shtator 2016, tarifat e aplikuara nga Albtelecom jane perfaruar ndjeshem me nivelin mesatar te vendeve te rajonit.

4. Rregullimi i tarifave me shumice te aksesit ne infrastrukturen e rrjeteve fikse ne Shqiperi

4.1. Alternativat per rregullimin e tarifave

Sipas nenit 57 te ligjit 9918, **Metoda e rregullimit të tarifave**:

1. AKEP-i zbaton rregullimin e tarifave nëpërmjet metodave të mëposhtme:

a) përcaktimit të nivelit minimal ose maksimal të tarifave;

b) korrigjimit të ecurisë së tarifave, duke përcaktuar kushte të tilla si:

i) kufirin maksimal të normës së ndryshimit (rritjes/uljes) të mundshëm të tarifës brenda një periudhe të caktuar kohe;

ii) raportin maksimal të rritjes së tarifës, që imponohet nga rritja e çmimeve të elementeve përbërëse (inputeve), brenda një periudhe kohe të caktuar;

iii) procedura, që do të përdoret për përcaktimin ose llogaritjen e tarifës, përfshirë detyrimin për orientimin në kosto, përcaktimin e kostove efiçente, që mundëson realizimin e një fitimi të arsyeshëm;

c) përcaktimin e një periudhe kohore, në asnjë rast më të gjatë se 12 muaj, gjatë së cilës ndalohet rritja e tarifave mbi nivelin aktual të tyre në një treg përkatës.

2. Në rregullimin e tarifës, bazuar në pikën 1 të këtij neni, AKEP-i vlerëson edhe të dhënat më të fundit për:

a) praktikën më të mirë të vendeve të BE-së;

b) tarifat mesatare të vendeve të BE-së;

c) tarifat e vendeve të rajonit me zhvillim të ngjashëm me Republikën e Shqipërisë;

ç) raportet ndërmjet tarifave të shumicës dhe pakicës;

d) normën e fitimit të arsyeshëm, të realizuar nga sipërmarrësit e tjerë të komunikimeve elektronike në vendet e BE-së dhe në vendet me zhvillim të ngjashëm me Republikën e Shqipërisë.

3. Metodat e rregullimit të tarifave mund të jenë të kombinuara.

4. Sipërmarrësit, që kanë detyrimin për të zbatuar detyrimet e veçanta dhe rregullimin e tarifave, sipas pikave 1 dhe 2 të nenit 56, duhet të aplikojnë paraprakisht në AKEP për miratimin e tarifave, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara në vendimin e AKEP-it për rregullimin e tarifave.

5. AKEP-i ose një ekspertizë kontabël e pavarur e përzgjedhur nga ajo, verifikon përputhshmërinë e tarifave nën rregullim me metodën dhe kushtet e përcaktuara për rregullimin e tarifave.

Sipas percaktimeve te mesiperme dhe perfundimeve te analizes se tregut dhe ketij dokumenti ne kapitujt e meparshem, AKEP ne seksionet ne vijim propozon metoden e rregullimit te tarifave

per sherbimet e Albtelecom, per te cilat ky operator eshte percaktuar me statusin me FNT ne dokumentin "*Analizë e tregjeve me shumicë të aksesit broadband ne Internet dhe Linjave me Qira- Dokumenti Perfundimtar*", dhe Vendimin me Nr___date, 22.12.2016.

Benchmarku

Nga krahasimi i tarifave te LLU te Albtelecom me vendet europiane ne Kapitullin III te ketij dokumenti, AKEP evidentoi se tarifa aktuale e Albtelecom per aksesin ne nen-qark (SLU) qe eshte tarifa e aplikuar per Full LLU eshte 26% me ulet se mesatarja e vendeve europiane (45% me e ulet se mesatarja e BE27 ne vitin 2013), dhe me uleta krahasuar me tarifen mesatare Full LLU te vendeve te BE. Nderkohe edhe tarifa me pakice e Albtelecom ne nivelin 700 lek/muaj me TVSH eshte shume me e ulet se tarifa mesatare ne vendet e BE dhe me e uleta ne rajon. Njekohesisht edhe tarifa e Albtelecom per sherbime te integruara Internet dhe telefoni si "i+fiks" eshte shume me e ulet se tarifa mesatare ne vendet BE. Ne kete menyre perdorimi i tarifave benchmark per nivelin e tarifave me shumice te LLU do te conte ne rritje nga niveli actual por edhe ne probleme te margin squeeze pasi do te ishte shum me e larte se tarifa perkatese me pakice, nderkohe qe kjo tarife eshte shume me e ulet se niveli mesatar ne vendet e BE (mbi 10 euro ne muaj).

Cmimet relative me shumice

Tregjet e analizuara jane tregje te nderlidhura dhe sherbimet per te cilat Albtelecom eshte percaktuar me FNT perbejne inpute per operatoret e tjere per ofrim te sherbimeve ne nivel me pakice, kryesisht akses broadband. Sherbimet dhe tarifat e tyre kane lidhje me njera tjetren pasi i referohen dhe niveleve te ndryshme te sherbimeve me shumice, dhe niveleve te ndryshme te investimeve qe duhet te kryhen nga operatoret e tjere per te arritur deri tek perdoruesi fundor, sic reflektohen nga skema e Shkalles se Investimeve (Ladder of Investment) e paraqitur me poshte.

Figura 7: Shkalla e Investimeve



Burimi: BEREC

Skema e mesiperme tregon nivelin e inputeve me shumice apo produkteve te aksesit qe nje operator (alternativ/perfitues aksesi) duhet te bleje per te arritur perdoruesin fundor ne varesi te infrastruktures qe zoteron vet operatori. Ne krye te shkalles eshte operatori qe zoteron rrjetin e vet te aksesit tek perdoruesi fundor dhe nuk ka nevoje per sherbime aksesi nga operatore te jere, dhe ne fund qendrojne ofruesit e sherbimeve si rishites qe nuk kane infrastrukture rrjeti dhe bazohen teresisht ne infrastrukturen e opartorit ofrues i aksesit. Tarifimi i sherbimeve te aksesit me shumice duhet te jape sinjalet e duhura per perfituesin dhe ofruesin e aksesit per te krijuar stimuj per investime eficente ne infrastrukture dhe raportet e cmimeve te produkteve te ndryshme duhet te refekektojne shkallen e burimeve/infrastruktures se vene ne dispozicion nga ofruesi i aksesit.

AKEP ne rregullimin e tarifave te aksesit broadband me shumice ne vitin 2014, ka bere nje lidhje midis tarifave per akses ne LLU dhe tarifave te aksesit bitstream, duke percaktuar qe tarifa e aksesit bitstream nuk mund te jete me e ulet se tarifa e aksesit te perbashket ne LLU, per shkak se per aksein bitstream ofruesi i aksesit vendos me shume burime/infratsrukture ne dispozicion te operatorit perfitues, dhe ky i fundit ka nevoje per me pak investime ne rrjet per te arritur perdoruesin fundor se ne rastin e LLU.

<u>Wholesale v Retail</u>

Nje ceshtje tjeter e rendesishme ne percaktimin e tarifave te produkteve te ndryshme te aksesit eshte edhe raporti i tarifave me shumice dhe me pakice, ku tarifa me shumice nuk duhet te jete

me e larte se tarifa me pakice pasi krijon probleme te ‘margin squeeze’ duke mos i krijuar mundesi operatorit perfitues te konkurroje ne nvel me pakice me ofruesin e aksesit. Ne rregullimin e tarifave ne vitin 2014, AKEP ka vendosur nje sere kushtesh per te evituar kete problem ne tarifat e aksesit bitstream (rregullim me metoden ‘retail minus) dhe linjave me qira me shumice (te jene te pakten 20% me te lira se tarifat sherbimeve respektive me pakice).

AKEP ne dokumentin e nxjerre ne keshillim public evidentoi se tarifa me shumice per aksesin ne nen-qarkun lokal (full SLU) te Albtelecom (678 lek/muaj pa TVSH) eshte me e larte se tarifa me pakice e paketes familjare Standarde 583 lek/muaj pa TVSH (700 lek/muaj me TVSH). Megjithate vlen te theksohet se sic eshte evidentuar ne analizen e tregut te telefonise fikse (2015) dhe aksesit broadband 2016, paketa familjare e cituar ka humbur rendesine e meparshme (mos-rritja e tarifes per shkaqe sociale) pasi paketat e tjera te reja te Albtelecom me sherbime te integruara jane shume me te perdorura.

Nderkohe ne lidhje me tarifat e linjave me qira, nuk ka probleme per raportin e cmimeve me shumice dhe me pakice. Per tarifat e aksesit bitsream, nese perdorim paketat standarde te Internetit ADSL, kushtet Retail -50% dhe Retail -30% jane te zbatuara, pasi tarifat standard me pakice te Albtelecom jane shume te larta. Megjithate ne baze te zhvillimeve dhe tendencave te tregut (paketat bundle dhe shpejtesia me perdorur e aksesit ne Internet 4-10 Mbps), AKEP gjykon te rishikoje bazen e krahasimit, duke i krahasuar tarifat e aksesit bitstream me paketa bundle me te perdorura te Albtelecom si “i+fiks”. Ne baze te tarifave aktuale te Albtelecom per paketat bundle, AKEP gjykon te mere ne konsiderate si tarife reference me pakice, paketen “i+fiks 1499” e cila perfshin nder te tjera akses ne Internet me shpejtesi 6 Mbps me tarife 1499 lek/muaj me TVSH. Bazuar ne cmimin mujor te paketes “i+fiks 1499”, pa TVSH, duke aplikuar skonton prej 50% per aksesin bitsream ne nivel Ethernet, per me pak se 100 porta, derivohet tarifa me shumice prej 625 lek/muaj per akses bitstream ne me pak se 100 porta me shpejtesi 6 Mbps. Ky nivel perben nje reduktim me 18% nga tarifa aktuale me shumice e Albtelecom per akses bitstream ne me pak se 100 porta me shpejtesi 6 Mbps.

Per sa me siper, bazuar ne zhvillimet e tregut me pakice ne Shqiperi (por edhe ne vendet te tjera), ku paketat bundle zene peshen kryesore ne paketat tarifore te operatoreve dhe te kerkuara nga perdoruesit e tregut masiv (WCA), raportin e cmimeve me shumice dhe me pakice, cmimet relative me shumice te produkteve te aksesit, komenteve te operatoreve ne keshillim publik si

dhe rekomandimet e KE/BEREC per rregullimin e tarifave me shumice te aksesit broadband (Analiza e tregut-versioni perfundimtar), AKEP gjykon qe tarifat e aksesit bitstream dhe te aksesit te LLU te rishikohen si me poshte:

1. Bazuar ne metoden e rregullimit te tarifave bitstream akses sipas analizes 2014 (retail -50% per ethernet) si dhe ne tendencen qe paketat Internet+Telefoni si i+fiks jane paketat me te perdorura, ne aplikimin e metodes "retail -50%", te merret ne konsiderate paketa e Albtelecom "i+fiks 1499 lek/muaj" e cila perfshin akses ne Internet me shpejtesi 6 Mbps.
2. Bazuar ne cmimin mujor te paketes "i+fiks 1499", pa TVSH, duke aplikuar skonton prej 50% per aksesin bitsream ne nivel Ethernet, per me pak se 100 porta, derivohet tarifa me shumice prej 625 lek/muaj per akses bitstream ne me pak se 100 porta me shpejtesi 6 Mbps.
3. Niveli i tarifes ne piken 2 perben nje reduktim me 18% nga tarifa aktuale me shumice e Albtelecom per akses bitstream ne me pak se 100 porta me shpejtesi 6 Mbps, dhe per te ruajtur strukturen aktuale te tarifave per shpejtesite e tjera te aksesit bitstream, ky reduktim te aplikohet ne te gjitha tarifat aktuale te Albtelecom ne nivel Ethernet dhe IP, me me pak se 100 porta dhe me shume se 100 porta.
4. Me qellim ruajtjen e raportit te cmimeve te aksesit bitstream dhe LLU, reduktimi prej 18% te aplikohet edhe per tarifat mujore aktuale te aksesit LLU ne rrjetin Albtelecom.

4.2. Tarifat per LLU dhe Tuba ne nivel local (Tregu WLA)

Sipas perkufizimit te tregut perkates ne dokumentin e analizes se tregut, sherbimet kryesore te ofruara nga Albtelecom per kete treg jane aksesi ne LLU dhe sherbimet e aksesit ne tubacione ne nivel local/urban. Tarifat aktuale te Albtelecom per aksesin ne qarkun e hapur local jane percaktuar nga AKEP ne Analizen e tregut ne vitin 2014, ne te cilen AKEP ka percaktuar se Albtelecom duhet te vazhdoje te aplikoje tarifat e miratuara me VKD nr.1365, date 13.04.2011, duke saktesuar qe per linjat e aksesuara ne MSAN per LLU, Albtelecom te aplikoje tarifat perkatese te aksesit (te plote dhe te perbashket) në nën-rrjetin lokal. Migrimi ne rrjetin NGA, me modelin FTTN nga Albtelelcom, con ne zvogelimin e rrjetit te aksesit dhe qarqeve locale (local

loops), dhe praktikisht ato mund te konsiderohen sub-loops: lidhja MSAN perdorues fundor me linje bakri.

Keto tarifa te Albtelecom jane bazuar ne rezultatet e modelit BULRAIC te vitit 2010, te kryer nga AKEP me konsulence nderkombetare. Modeli ne vitin 2010 eshte bazuar ne strukturen e rrjetit PSTN dhe jo ne NGN/NGA qe aktualisht ka Albtelecom. Aplikimi i tarifes se nen-qarkut local per akses ne qarkun LLU ne MSAN, eshte konsideruar nga AKEP si nje perafrim me i mire i kostos se aksesit ne qarkun lokal ne kushtet e migrimit te plote te Albtelecom ne NGA (zvogelimi i gjatesise se qarkut local), megjithese teknikisht nen-qarku local (sub-loop) eshte i ndryshem nga qarku qe lidh perdoruesin fundor me MSAN.

Metoda e rregullimit per LLU

AKEP vlereson qe tarifat me shumice e aksesit ne qarkun local (LLU) te Albtelecom te rregullohen sipas metodes se percaktimit te cmimit maksimal. Duke marre ne konsiderate raportin e cmimeve me shumice dhe me pakice, cmimet e sherbimeve te tjera te aksesit me shumice (aksesi bitstream) dhe normen e ndryshimit te tyre, bazuar ne arsyetimin e Seksionin 4.1 tarifat mujore te Albtelecom duhet te reduktohen me 18% nga niveli aktual. Tabela e meposhteme paraqet nivelin e ri te tarifave te aksesit LLU te Albtelecom duke filluar nga 1.07.2017 dhe krahasimin me tarifat aktuale.

Tabela 8: Tarifat me shumice te Albtelecom per aksesin LLU (2017)

Shërbimi	Tarifa Aktuale	Tarifa e Re Maksimale (1.07.2017)	Ndryshimi %
Tarifa Mujore			
Akses i plote në rrjetin local (LLU)-MSAN	678	556	-18%
Akes i perbashket në rrjetin local (LLU)-MSAN	407	334	-18%
Tarifa instalimi për LLU			
Instalimi I aksesit te plote ne rrjetin lokal	1,686	**1,686**	0%
Instalimi I aksesit te perbashket në rrjetin lokal të hapur	2,452	**2,452**	0%

Shenim: Tarifat ne LEK pa TVSH

Tarifa e re me shumice e aksesit te plote ne nen-qarkun local (qark local ne nivel MSAN) eshte derivuar nga norma e ndryshimit per tarifat me shumice te aksesit bitstream (te shpjeguar me lart), dhe garanton qe niveli i ri kesaj tarife te jete me i ulet se tarifa me pakice e pajtimit mujor per paketen “Familjare” 583 lek/muaj pa TVSH (700 lek me TVSH), si dhe me marzh

mjaftueshem krahasuar me tarifat me pakice te paketave bundle me te perdorura nga perdoruesit e Albtelecom.

Metoda e rregullimit per Aksesin ne tubacione ne nivel local

Ne vijim te perfundimeve te analizes se tregut dhe Seksionit 4.1 te ketij dokumenti, AKEP vlereson qe tarifat me shumice e aksesit ne tuba ne nivel local/urban te Albtelecom te rregullohen sipas metodes se percaktimit te cmimit maksimal dhe duke marre ne konsiderate dhe tarifat ne vendet e tjera, duke percaktuar nivelin actual te tarifave te Albtelecom, pas reduktimit te ndjeshem ne Tetor 2016, si cmime tavan/maksimale per kete sherbim dhe vlerave ne tabelen e meposhtme.

Tabela 9: Tarifat Maksimale te aksesit ne tubacione ne rrjetin Lokal te Albtelecom (2017-)

		Tarife Fillestare (Euro/km	Tarifat Maksimale per akses ne tuba ne nivel local/urban		
	Distanca (Km)	Diametri (mm)	deri ne 10 mm+0.5	10-20 mm+0.5	20-30 mm+0.5
D1	<0.2	13,832	11,066	12,449	13,832
D2	0.2-5	11,066	8,299	10,097	12,449
D3	5-20	11,066	7,608	9,406	11,757
D4	20-40	11,066	7,193	8,852	11,066
D5	40-80	11,066	6,639	8,299	9,959
D6	80-160	11,066	6,086	7,746	9,406
D7	160-300	11,066	5,533	6,916	8,299
D8	>300	11,066	4,980	6,363	7,193

Shenim: Tarifat ne Lek[3] pa TVSH

AKEP do te rishikoje nivelin benchmark te tarifave ne tubacione ne menyre periodike, dhe bazuar ne keto nivele si dhe zhvillimet dhe kushtet e tregut ne Shqiperi, perfshire zhvillime ne baze te ligjit 120/2016, do te vleresoje nevojen per rishikim te metodes apo nivelit te ketyre tarifave.

[3] Tarifat aktuale te Albtelecom jane ne Euro. AKEP ka bere konvertimin ne LEK, duke perdorur Kursin e Kembimit 1 Euro=138.32 Lek, i perdorur dhe nga BEREC ne dokumentin BoR (16) 218 "*Termination rates at European level-July 2016*" December 2016.

4.3. Tarifat per aksesin bitstream (Tregu WCA)

Metoda e rregullimit

AKEP gjykon qe tarifat me shumice e aksesit bitstream te Albtelecom te rregullohen sipas metodes se percaktimit te cmimit maksimal dhe minimal, sipas nenit 57, pika 1/a te Ligjit 9918. Vlerat maksimale te tarifave te aksesit bitstream do te jene sipas tabeles se meposhtme:

Tabela 10: Tarifat maksimale mujore te aksesit bitstream te Albtelecom (1.07.2017-)

	Opsioni 1: Bitstream ne Ethernet		Opsioni 2: Bitstream ne IP	
Shpejtesia Download	deri 100 porta	>100 porta	deri 100 porta	>100 porta
2 Mbps	382	345	450	405
4 Mbps	508	459	599	540
6 Mbps	625	566	738	664
8 Mbps	832	754	984	886
10 Mbps	898	812	1,059	954
12Mbps	990	894	1,169	1,052
16 Mbps	1,138	1,033	1,345	1,205

Vlerat e mesiperme jane percaktuar nga AKEP sipas arsyetimit te perdorur ne fillim te ketij kapitulli, dhe me 1.07.2016 perbejne nje reduktim me 18% ne krahasim me te gjitha tarifat aktuale te Albtelecom, ne fuqi prej 1.10.2016. Sic eshte theksuar ne Seksionin 4.1, si reference per percaktimin e tarifave maksimale te mesiperme eshte marre tarifa me pakice e Albtelelcom 'i+fiks 1499' me shpejtesi download 6 Mpbs, si paketa me perfaqsuese ne tregun me pakice te aksesit broadband, ku tendenca eeshte per perdorim te larte te paketave bundle dhe me shpejtesi aksesi broadband me te perdorur ne nivelet 4-10 Mbps.

Ne lidhje me cmimin minimal te aksesit bitstream, ne vijim te kushtit te vendosur edhe ne vitin 2014, si dhe arsyetimeve ne seksionin e meparshem, tarifat e tabeles 10 me siper nuk duhet te jene me te lira se tarifa e aksesit te perbashket per LLU (nivel MSAN), qe sipas ketij dokumenti do te duhet te jete 334 lek/muaj.

4.4. Tarifat per Linjat me qira (Tregu WHQA): Albtelecom

Ne lidhje me rregullimin e tarifave per sherbimet e tregut me shumice aksesit me cilesi te larte ne vendndodhje fikse (WHQA), qe kryesisht permban sherbimet e linjave me qira, AKEP propozon vazhdimin e rregullimit si ne vitin 2014 te aksesit me shumice ne Ethernet ne rrjetin NGN dhe rrjet tradicional, duke sanksionuar nivelin actual te tyre. Tarifat e Albtelecom per kapacitetet me qira Ethernet ne rrjet tradicional dhe Ethernet ne NGN duhet te rregullohen sipas metodes se cmimit maksimal, sipas vlerave ne tabelen e meposhteme:

Tabela 11: Tarifat maksimale te linjave me qira me shumice te Albtelecom (1.07.2017-)

Shpejtesia e transmetimit te te dhenave	Tarifa e Instalimit	Tarifa Mujore	
		Per linje	per km
2 Mbps	4,905	13,735	267
34 Mbps	38,500	62,500	750
155 Mbps	43,000	125,000	1,500

Shenim: tarifat ne Lek pa TVSH

Njekohesisht, AKEP gjykon te vazhdoje te vendose kushtin qe tarifat me shumice te linjave me qira te jene te pakten 20% me te lira se tarifat sherbimeve respektive me pakice.

5. Efektet e pritshme

AKEP ne kete dokument ka vendosur per percaktimin e tarifave maksimale te Albtelecom per sherbimet me shumice te aksesit ne LLU, infrastrukturen fizike te tubave ne nivel lokal, aksesit bitstream ne nivel Ethernet dhe IP, dhe linjave me qira, te cilat perbejne reduktim me 18% te tarifave mujore te aksesit ne LLU dhe aksesit bitstream nga tarifat aktuale dhe ruajtjen/sanksionimin e nivelit maksimal te tarifave te tubave dhe linjave me qira, pas reduktimeve te ndjeshme te tyre nga Albtelecom kohet e fundit.

Nepermjet percaktimeve ne kete dokument per rregullimin e tarifave te aksesit ne rrjetet fikse, AKEP synon realizimin e objektivave te ligjit 9918, per nxitjen e konkurrences per sherbimet e aksesit broadband. AKEP pret qe kjo te realizohet nepermjet reduktimit te kostove te ndertimit te rrjeteve broadband dhe ofrimit te sherbimeve te aksesit broadband per perdoruesit fundore, konsumatore dhe biznes, dhe njekohesisht rritjen e cilesises se ketyre sherbimeve. Ne menyre me specifike rregullimi i tarifave qe percaktohet ne kete dokument, si dhe masat e tjera rregullatore te percaktuara ne dokumentin e analizes se tregut 2016, pritet te nxise:

- Fillimin e perdorimit te infrastruktures aktuale dhe te re te mundshme te rrjetit lokal te Albtelecom (LLU), duke reduktuar ekzistencen jo-eficente te shume rrjeteve lokale fikse paralele;
- Rritjen e perdorimit te perbashket te infrastruktures pasive (tubacione), ne zona urbane te Albtelcom, dhe indirect edhe ne zona nder-urbane nepermjet perdorimit te procedures se zgjidhjes se mosmarrveshjeve (ligji 9918 dhe ligji 120/2016), duke cuar ne rritjen e cilesise dhe sigurise se rrjeteve broadband nepermjet perdorimit me te madh te rrjeteve nen-tokesore dhe zvogelimin e rrjeteve ajrore te pasigurta);
- Rritjen e perdorimit te sherbimeve te aksesit bitstream nepermjet rrjetit ALbtelecom.

Ne vijim edhe te skemes se shkalles se investimeve (Ladder of Investiment) operatoret e ndryshem kane mundesi dhe alternativa te ndryshme per rritjen dhe zgjerimin e zonave te mbulimit me akses broadband dhe cilesise se sherbimeve:

- Operatoret alternative te rrjeteve fikse me prezence rrjeti local aksesi (lidhje direkte me perdoruesin fundore) mund te zgjerojne zonat nepermjet produkteve te LLU dhe tubacioneve

ne zona urbane te Albtelecom (dhe operatoreve te tjere sipas percaktimeve te aketeve te tjera ligjore dhe nen-ligjore) si dhe mund te sistemojne rrjetet tyre te aksesit nepermjet perdorimit te tubave;

- Operatoret qe synojne segmentin e biznesit dhe per lidhje te pjeseve te ndryshme te rrjeteve te tyre mund te perdorin sherbimet e linjave me qira;
- Aksesi bitstream ne nivel Ethernet dhe IP krijon mundesi per rritje te bazes se perdoruesve fundore ne shume zona deri ne nivel kombetar dhe me pak kosto/investime shtese.

Rregullimi i propozuar nga AKEP konsiston ne perdorimin e metodes se cmimit maksimal, bazuar ne tarifat benchmark te vendeve te rajonit apo ne tarifat me pakice, per shkak edhe te mungeses se informacionit per kostot e ofrimit eficent te ketyre sherbimeve. Kjo metode vleresohet e pershtatshme dhe e arsyeshme nga AKEP, dhe nese operatoret nen-rregullim kane pretendime per nivelin e tarifave dhe kostove, duhet te argumentojne llogaritjen e kostove sipas parimeve te rregullores se AKEP per ndarjen e llogarive dhe llogaritjen e kostove.

Nderkohe, per perspektiven afat-mesme dhe afat-gjate, AKEP vlereson se alternativa me e mire per rregullimin e tarifave te produkteve dhe sherbimeve me shumice te aksesit ne rrjetet fikse eshte perdorimi i rekomandimeve me te fundit te KE dhe BEREC[4] te cilat rekomandojne nder te tjera orientimin ne kosto te tarifave dhe/ose heqjen e detyrimit te rregullimit ex-ante te ketyre tarifave duke shtuar detyrimet e mos-diskriminimit. Megjithate sic eshte theksuar ne dokumnetin e analizes se tregut, aktualisht ky lloj rregullimi ne Shqiperi paraqet komplikacione te cilat do te rrisnin pasigurine e rregullimit te tarifave te aksesit broadband me shumice, dhe keto alternativa (perfshire mundesine e pergatitjes se nje modeli BULRIC per rrjetin NGN/NGA te Albtelecom) do jene objekt vleresimi ne dy vitet e ardhshme nga AKEP.

AKEP ne dokumentin e analizes se tregut 2016 dhe ne kete dokument, i ka kushtuar nje rol te vecante rregullimit te infrastruktures fizike pasive (tubacione). Rregullimi i percaktuar nepermjet detyrimeve per akses dhe rregullim tarife te tubave ne keto dokumenta si dhe percaktimet e ligjit 120/2016 dhe akteve te tjera nen-ligjore aktuale dhe qe pritet te miratohen, pritet te kene impakt pozitiv ne rritjen e stimujve per investime/konkurrence me te madhe ne infrasruktukture aktive,

[4] *COMMISSION RECOMMENDATION of 11 September 2013 on consistent non-discrimination obligations and costing methodologies to promote competition and enhance the broadband investment environment (2013/466/EU)*
BEREC: Common Position on Layer 2 Wholesale Access Products (6 October 2016)

reduktim te kostove te rrjeteve broadband dhe perfundimisht sherbime me cilesi me te larte te aksesit broadband dhe kosto me te uleta per perdoruesit fundore, konsumatore dhe biznes.

Aneks 1: Lista e Shkurtimeve të Shteteve

Simboli	Shteti
AT	Austri
BE	Belgjik
BG	Bullgari
CH	Zvicër
CY	Qipro
CZ	Çeki
DK	Danimarkë
DE	Gjermani
EE	Estoni
EL	Greqi
ES	Spanje
FI	Finlandë
FR	Francë
HR	Kroaci
HU	Hungari
IE	Irlandë
IS	Islandë
IT	Itali
LT	Lituani
LV	Letoni
LU	Luksemburg
FYROM	Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë
NL	Hollandë
NO	Norvegji
PL	Poloni
PT	Portugali
RO	Rumani
RS	Serbi
SE	Suedi
SI	Slloveni
SK	Sllovaki
TR	Turqi
UK	Mbreteria e Bashkua(Angli)

Aneks 2: Komentet e keshillimit publik dhe qendrimi i AKEP

AKEP me VKD nr.2682, datë 07.07.2016 miratoi publikimin e dokumentit "Miratim për këshillim publik të Dokumentit: "Rregullimi i tarifave të sipërmarrësve me FNT në tregjet me shumicë të aksesit broadband dhe në infrastrukturën aktive dhe pasive në rrjete fikse –Këshillim Publik". Në këtë dokument të publikuar në faqen zyrtare www.akep.al, AKEP kishte hartuar disa pyetje për të marrrë opinionin e palëve të interesuara. Në përfundim të fazës së këshillimit publik me 15.09.2016 në AKEP depozituan komente:

- Albtelecom sh.a., nëpërmjet shkresës me Referencë Nr. Prot 7773, datë 15.09.2016 (Referencë e AKEP Nr.1527 Prot., datë 16.09.2016);
- Telekom Albania sh.a., me shkresën Nr. 5676 Prot., datë 13.09.2016 (Referencë e AKEP, Nr. 1205/4 Prot., datë 19.09.2016);
- Vodafone Albania sh.a., me shkresës Nr. LRD/0100/OX, datë 15.09.2016 (Referencë e AKEP Nr.1205/5 Prot., datë 20.09.2016).

AKEP i falenderon të gjithë pjesëmarrësit për kontributet e dhëna në proçesin e këshillimit publik. Ky dokument përmban komentet e bëra me shkrim, te permbledhura dhe sipas pyetjeve te keshillimit, dhe qëndrimin e AKEP mbi komentet.

1. **A janë pasqyruar drejt tarifat benchmark të vendeve të BE dhe rajonit për shërbimet e LLU dhe askesit në tubacione në Seksionin 3?**

<u>ALBTELECOM</u>
Në lidhje me "Tarifat benchmark të aksesit për LLU" (pika 3.1 në dokument), Albtelecom mendon se, përgjithësisht janë trajtuar korrekt, dhe nga informacioni i dhënë duket se tarifat aktuale të Albtelecom janë më të ulëta se mesatarja e vendeve të BE-së në nivele 35%-45%, apo të krahasueshme me ato të 5 vendeve të BE-së që kanë tarifën më të ulët dhe nën nivelin 6 euro/muaj.
Në lidhje me "Tarifat benchmark të aksesit në tubacione"(pika 3.2 në dokument), sipas Albtelecom analiza e bërë nuk qëndron për një sërë arsyesh dhe rithekson:

- Niveli i tarifave mbi të cilat është bazuar AKEP, ka diapazon shumë të madh dhe paraqiten mënyra të ndryshme tarifimi në këto vende dhe krahasimi shumë kompleks;
- Informacioni për tarifat i referohet aksesit në tubacione në pjesën e rrjetit lokal, pra nuk përfshihen tarifat për tuba në rrjet kryesor;
- Në shumë raste aplikojnë tarifa të konsiderueshme one-off për proçesimin e kërkesës dhe planin teknik, që nga ana e Albtelecom nuk aplikohen.

Albtelecom mendon se krahasimi apo gjetja e tarifave nga ana e AKEP të tilla si "AVG region", "AVG cm2", "AVG region 20-40 mm2" jo vetëm që është e pavend, por edhe e pabazuar pasi nuk janë të krahasueshme dhe nuk mund të shërbejë për të dalë në përfundimin e AKEP, se këto tarifa janë më të larta se ne rajon dhe kufizojnë përdorimin e tubave.

<u>TELEKOM ALBANIA</u>
Informacioni i dhënë nga ana e AKEP në këtë dokument të analizës së tregut në lidhje me tarifat benchmark për vendet e BE-se për shërbimet e LLU është pasqyruar drejt duke dhënë dhe burimin e informacionit nga janë marrë këto të dhëna. TA shprehet se AKEP i është referuar të dhënave të Cullen International, por per nje gjykim me objektiv duhet të jepen të dhënat mbi referencat specifike dhe precize mbi burimin e këtij raporti të Cullen International. Nga sa ka vënë re TA per tarifat LLU (full/share) dhe të aksesit në tubacione janë më të larta se mesatarja e vendeve europiane dhe të rajonit, gjë që tregon se se konkurrenca në këto tregje është ende larg të qënurit efektive dhe ka nevojë për një ndërhyrje rregullatore nga ana e AKEP. Për më tepër që Albtelekom gëzon

një pozitë dominante në këto tregje, duke qënë operatori më i madh si në shtrirjen e rrjetit të aksesit për LLU dhe të tubacioneve në nivel lokal apo qendror, ashtu dhe në terma të të ardhurave dhe të numrit të pajtimtarëve që ai zotëron.

VODAFONE

Pavarësisht progresit së fundmi, niveli i aksesit broadband në internet nga vendodhje fikse është ende larg mesatares së vendeve të BE. Vodafone është i mendimit se një nga faktoret pengues primarë është dhe tarifimi i lartë në nivel shumice, kombinuar me aplikimin e tarifave antikonkurruese (margin squeeze) në tregun e pakicës, duke sjelle si argument hetim nga AK dhe ankesen e bere ndaj Albtelecom nga VA, per paken 700 leke. Ndaj, VA i kërkon AKEP të monitorojë me kujdes (dhe në bashkëpunim me AK) dhe në vazhdimësi tregun, pasi pozita e operatorit inkumbent (në nivelin e pakicës dhe në nivelin e shumicës), infrastruktura e tij e padublueshme, shtrirja kombëtare e rrjetit fiber dhe integrimi vertikal i garantojnë këtij lojtari një avantazh të dukshëm në tregjet e pakicës, e për rrjedhojë krijon kushtet për zbatimin e mundshëm të praktikave antikonkurruese 'margin squeeze' nga ky i fundit.

Qëndrimi i AKEP

Ne lidhje me komentet e Albtelecom AKEP sqaron se, nga krahasimet e kryera u evidentua se tarifat e Albtelecom per aksesin ne tubacione ishin shume me te larta se vendet e rajonit, deri ne Shtator 2016. Me reduktimin e ndjeshem te tarifave ne Shtator 2016, tarifat e aplikuara nga Albtelecom jane perafruar ndjeshem me nivelin mesatar te vendeve te rajonit. Per keto dhe per disa saktesime te tjera, AKEP ka mbajtur qendrim me te hollesishem ne dokumentin perfundimtar te Analizes se Tregut si dhe ne dokumentin perfundimtar te rregullimit te tarifave. Gjithashtu sqarojme Vodafone se AKEP ne vijim te perfundimeve te dokumentit te nxjerre ne keshillim public dhe komenteve te marra gjate ketij procesi keshillimi, ne dokumentin perfundimtar ka perfshire sqarimet e duhura ne lidhje me problemin e evidentuar nga Vodafone. Vlen te theksohet se sic eshte evidentuar ne analizen e tregut te telefonise fikse (2015) dhe aksesit broadband 2016, paketa familjare e cituar ka humbur rendesine e meparshme, dhe nje shkak i problemit eshte edhe mos-rritja e tarifes me pakice per shkaqe sociale, dhe paketat e tjera te reja te Albtelecom me sherbime te integruara jane shume me te perdorura, dhe AKEP ka bazuar analizen e raportit te tarifave me pakice dhe me shumice ne keto paketa me te perdorura (i+fiks), dhe rregullimet e kryera nga AKEP eliminojne problemin e evidentuar.

2. A jeni dakort me propozimin e AKEP për reduktimin e tarifave të shërbimeve të LLU të Albtelecom me 28% dhe mendoni se ky reduktim do të rrisë/krijojë interes për përdorimin e këtyre shërbimeve nga operatorët e tjerë?

ALBTELECOM

Lidhur me propozimin e AKEP për reduktimin e tarifave të shërbimeve të LLU të Albtelecom me 28% , Albtelecom shprehu modakortësinë e tij dhe paraqet në mënyrë të përmbledhur argumentat si më poshtë:

- Vetë AKEP ka evidentuar në dokumentin e Analizës se tarifat tarifat aktuale për aksesin në LLU janë më të ulëta se mesatarja e vendeve të BE- së në nivele deri në 35-45% më të ulëta, apo të krahasueshme me ato të 5 vendeve të BE, të dala nga një model kostoje, pavarësisht ndryshimeve të rrjetit. Ndaj nuk ka vend për reduktim të mëtejshëm të tarifave LLU, për më tepër reduktim prej 28% të tyre. Mbeshtetja e AKEP në metoden maksimale bazuar në pajtimin mujor prej 700 lekësh, eshtë jo proporcionale dhe e pajustifikueshme për shak se:
    - Ky pajtim i vendosur nga Albtelecom nuk ka arritur të mbulojë kostot reale dhe ka qënë një zgjidhje e detyruar;
    - Numri i pajtimtarëve me këtë paketa vjen duke u ulur si pasojë e ofrimit të paketave dyshe dhe treshe dhe si rrjedhim nuk arrit te mbulloje kostot;
    - Nga vetë Akep kjo tarifë është evidentuar si e ulët në krahasi me vendet EU dhe rajonin.
- Nëse AKEP nuk përdor modeli kostoje duke qene se nuk i përgjigjet ndryshimeve te rrjetit, atehere ligji parashikon përdorimin e praktikave më të mira, por jo patjeter të mërrët refernce vendi me tarifa më të ulta.
- AKEP është shprehur se tarifat për akses në nivel SLU janë 26% më të ulëta se mesatarja e vendeve europiane. Krahasimi i tarifës për shërbimin SLU (LLU) me tarifën e pajtimit mujor të paketës 700 lek të Albtelecom nuk mund të qëndrojë për sa kohë që, në vendet e EU-së me të cilat është bërë krahasimi duke

qënëse tarifa e shërbimit të Albtelecom për SLU është 26% më e lirë se tarifa mesatare e vendeve të EU-së dhe tarifat e pajtimit mujor për paketat sdandarte të operatorëve incumbent janë shumë herë më të larta.

Në komentet e tij shtese, Albtelecom shprehet edhe për investimete kryera ne kete rrjet dhe moskthimin e këtij investimi ne kohe, duke qenese miremban një rrjetin për këtë shërbim, për të cilin nuk eshte shfaqur interes dhe nuk ka pritshmeri edhe per 5 vitet e ardhshme. Albtelecom gjukon se nuk mund të ketë rritje të interesit për këtë shërbim sa kohë që aplikimi dhe proaktiviteti i Albtelecom për shërbimet bitstream po zëvendëson interesin e operatorëve për shërbime LLU, ngjashmërisht me zhvillimet e fundit, dukshëm edhe në vendet europiane.

TELEKOM ALBANIA
TA mendon që reduktimi i ketyre tarifave është i nevojshëm në kontekstin në të cilin Albtelecom operon me një pozitë dominante në këtë treg. Reduktimi i tyre përkthehet në kosto më të ulëta për operatorët e tjerë, sidomos ata të rinj. Kjo gjë stimulon dhe zhvillon me tej konkurrencën në treg midis operatorëve dhe gjithashtu plotëson më mirë nevojat e konsumatorit. Ky reduktim është i nevojshëm për shkak të situatës së një konkurrence të dobët, pozitës dominante të Albtelecom, si dhe të interesit shumë të ulët të treguar nga shumë operatorë në tregun e LLU për të kërkuar akses, duke bërë që të nxitet më tej kërkesa nga ana e operatorëve të tjerë.

VODAFONE
Ne lidhje me tarifat VA bie dakort me AKEP, qe tarifat jane disa here me të larta se mesatarja BE, ndaj kanë nevoje të rishikohen në mënyrë të konsiderushme, gjitjashtu Vodafone sugjeron që njëkohesisht duhet të reduktohen dhe tarifat për instalim të aksesit të plotë dhe tarifat për instalim të aksesit të përbashkët (përveç tarifave të aksesit të plotë dhe tarifave të aksesit të përbashkët), pasi të gjithë këto tarifa në tërësi janë element që kanë penguar deri më sot shfrytëzimin e përbashkët dhe në mënyrë racionale të resurseve të operatorit inkumbent pa qënë nevoja e replikimit të rrjetit nga operatorët e tjerë të vegjël. Për tarifave e Bitstream, VA shprehet se është e nevojshme që ky treg të mbetet nën rregullim për sa kohë që nuk ka konkurrencë të provuar efektive në të, perfshire edhe rregullimi i tarifave.

Qëndrimi i AKEP

Duke marre ne konsiderate komentet e dhena, ndryshimet dhe reagimet e tregut, si dhe raportin e cmimeve me shumice dhe me pakice, cmimet e sherbimeve te tjera te aksesit me shumice (aksesi bitstream) dhe normen e ndryshimit te tyre, bazuar dhe ne arsyetimin e argumentuar ne dokumentin per rregullimin e tarifave, AKEP vleresoi qe tarifat mujore te Albtelecom per LLU duhet te reduktohen me 18% nga niveli aktual.

3. Cfarë mendoni për propozimin e AKEP për rregullimin e tarifave të aksesit bitstream të Albtelecom dhe vazhdimin e rregullimit të tyre me metoden "Retail minus"?

ALBTELECOM
Në lidhje me rregullimin e tarifave të aksesit bitstream të Albtelecom dhe vazhdimin e rregullimit të tyre me metodën "retail minus", Albtelecom ka sjelle argumenta përvec përgjigjeve ndaj petjeve edhe në një pjëse ku mbaj qendrim per dokumentin ne pergjithesi. Gjithashtu sjell në vëmëndje edhe komente mbi Dokumentin e Analizes. Duke u nisur nga rrethanat dhe zhvillimet më të fundit në tregun e aksesit broadband, (ËCA sipas ri-përkufizimit të ri) dhe bazuar në disa faktorë të tilla si:

- Rishikimi, përditësimi dhe ulja e tarifave të Bitstream të ndërmarrë nga Albtelecom me iniciativë të vet;
- Lidhja e 5 kontratave bitstream (afërsisht 2400 linja në funksionim) dhe mospasja në asnjë rast e mosmarrveshjeve për lidhjen e shërbimit apo adresim të ankesave të Operatorëve në AKEP cka tergon që nuk janë në diskutim ceshtja e tarifave dhe ligji i kërkesë-ofertës po funksionon në treg duke dhënë indikacionet për një konkurrencë eficiente në këtë treg;
- Zhvillimi pozitiv i shërbimeve boadband në tregun me pakicë i lidhur direkt me tregun me shumicë broadband qoftë në numrin në rritje të abonentëve, qoftë në normën e penetrimit (për familje/për popullësi);

Albtelecom i kërkon AKEP mospërcaktimin e tij si operator me FNT në tregun WCA dhe derregullimin e tarifavetë aksesit bitstream duke i dhënë mundësi atij të trajtojë në mënyrë komerciale dhe të jetë sa më fleksibël ndaj cdo kërkese të operatorëve alternativë kërkues të këtij shërbimi.
Nëse AKEP vlerëson të pamundur derregullimin e tarifave që shërbimet bitstream, atëherë duhet të mjaftohet me sanksionimin e tarifave në fuqi sipas metodës së "Përcaktimit të nivelit minimal ose maksimal të tyre" dhe duke hequr si pjesë e këtij rregullimi metodën "retail minus", implementimi në mënyrë të drejpërdrejtë i së cilës ka qenë dhe është i pamundur për një sërë arsyesh të argumentuara dhe të referuara nga ana jonë edhe në AKEP, nga të cilat:

a) Problematika në lidhje me menaxhimin e proçesit të përditësimit të Ofertës referencë;
   Ky proces kërkon kohë për tu hartuar, përshatur sipas paketave dhe publikuar, e cila mund ta kaloje afatin e një pakete të hedhur në treg, kur flasim për paketa retail. Ndryshimi i paketave retail, duken pasqyruar edhe në kontratën për bitstream me operatroet e tjere, por kjo bene të maundur pasyrimin në afat dhe permbushjen e detyrimeve rregullatore.
b) Vështirësi në kontrollin e kushtëzimeve / specifikimeve të produkteve të Operatorit përfitues tek përdoruesi fundor konform produkteve retail të Albtelecom;
   Aplikimi i drejrperdrejre bazuar ne paketat retail te Albtelecom do te kerkonte nga Albrelecom menaxhimin e procesit te kontrollit te respektimit te keryre kufizimeve dhe zbatimin e tyre ne perputhje me kushtezirnet ne paketat e tij retail , duke kufizuar keshtu fleksibilitetin /lirine ne treg te Operatorit perfirues ndaj sherbimit te ofruar pajtimtarit e vet.
c) Kushtëzimi në ofrimin e shërbimit Bitstream në rastin e aplikimit të metodologjisë "retail minus" në Planet Tarifore Standarte;
d) Interesi i shfaqur nga operatorët për akses broadband (Bitstream) të kushtëzuar vetë në kapacitetin në portë.
   Kushtezimi i pranuar nga keta operatore, lidhet vetem me kapacitetin e portes, por jo me specifikat e tjera të sherbimit internet, te tilla si limiti, lloji IP-se, etj. Kerkesa e tyre eshtë që Albtelecom te ofrojë cmime perkatese per kapacitet porte (2 Mbps, 4 Mbps, etj) dhe të mos kene kufizime ne ofrimin e sherbirnit te internetit te bazuar ne paketat perkatese me pakice te Albtelecom.

TELEKOM ALBANIA
TA gjykon si të nevojshme që në tregun me shumicë të aksesit bitstream të vazhdojë rregullimi i tarifave të aksesit për operatorin Albtelecom, pasi kushtet e këtij tregu nuk kanë ndryshuar shumë që nga analiza e fundit. Edhe pse shumica e operatorëve alternativë kanë bërë investime të konsiderueshme në shtrirjen më të madhe të rrjeteve të tyre me fibër optike dhe teknologji NGN/NGA, përsëri mbetet problem mbulimi jo i plotë i territorit me rrjet nga këta operatorë duke qënë se janë fokusuar në qëndra urbane. Rrjedhimisht shumë zona të tjera mbeten ende nën mbulim nga ana e Albtelecom.
Nisur nga zhvillimete tregut AKEP duke të ndërtojë një model për kalkulimin e kostove për operatorin Albtelecom, në mënyrë që përcaktimi i tyre të ishte i orientuar sipas kostove reale të manifestuara, duke reflektuar në menyrë më të saktë koston e ndërtimit të rrjeteve NGN/NGA. Ndertimi i një modeli të tillë është më efektiv në rregullim e tarifave se "Retail minus", duke qenese kjo e fundit favorizon Albtelecom duke i lënë pavaresi në vendosjen e tarifave në pakice nuk do të pasqyrojë në shumicë kostot reale.

VODAFONE
Në lidhje me metodologjinë, VA shprehet se AKEP duhet të përzgjedhë si metodë primare të zbatojë orientimin e tarifave në kosto dhe se çdo metodologji tjetër, qoftë ajo benchmark apo retail minus nuk duhet të jetë zgjedhja e parë. VA shpreh shqetësim se AKEP nuk i referohet për orientim 2013/466/EU. Ky Rekomandim përcakton qartë se vetëm metodologjia e orientimit në kosto është mënyra e duhur për rregullimin e tarifave, pasi çon drejt çmimeve të aksesit që pasqyrojnë maksimalisht çmimet e një tregu që konkurron në mënyrë efektive. Rekomandimi udhëzon NRA-të të zbatojnë metodologjinë e kostos brenda muajit Dhjetor 2016(BU LRIC+), udhëzim të cilin VA nuk e sheh të përqasur në dokumentin që propozon AKEP. Qasja ndaj ketij Rekomandimi do të sillte do ti vendosjte theksin nevojes per te garantuar barazia aksesi, e cila eshte shqetesim ne BE dhe ne Shqipëri. Zbatimi i Rekomandimit 11 së bashku me zbatimin e testit të margin squeeze mund të garantojnë konkurrueshëmri efektive në treg dhe shmangien e sjelljes abuzive nga operatori dominant.
Ky lloj testi kujtojmë që mund të zbatohet jo vetëm ex-post në bashkëpunim me Autoritetin e Konkurrencës, por edhe ex-ante për produktet e nivelit të shumicës, për të garantuar që tarifimi në nivel shumice nuk pengon konkurrencën në nivelin e pakicës dhe as e vonon atë. Gjithashtu VA vijon komentet e tij se në rast të përdorimit të metodave krahasimore, ato nuk duhet ti referohen vetëm vendeve të rajonit, por të orientohen në mënyrë gjithpërfshirëse tek të gjithë praktikat europiane në menyrë jo diskriminative, si ka qënë dhe rasti i rregullimit të

tarifave të terminimit celular. Praktikat e AKEP ne rregullimin e MTR kane perdorur Benchmark agresive, kurse per Albtelecom edhe pse incumbent dhe mban pozite dominuese perdoren qasje rreth mesatares se viteve te fundit.

Qëndrimi i AKEP

Mbas marrjes se komente dhe shqyrtimit te tyre, nisur edhe nga kushte specifike te tregut shqiptar, AKEP vleresoi dhe gjykoi te marre parasysh shume nga komente e operatoreve duke i reflektuar ne dokumenti perfundimtar te rregullimit te tarifave, duke rregulluar keto tarifa me metoden e cmimit maksimal. Gjithsesi analiza per normen e reduktimit (18%) te tyre eshte bazuar ne raportin e cmimeve me shumcie dhe me pakice, duke perdorur paketen 'i+fiks 1499", per arsuet e dhena ne dokumentin perfundimtar te rregullimit te tarifave.

4. Cili është opinioni juaj në lidhje me rregullimin e propozuar të tarifave të aksesit në tubacione të Albtelecom dhe ATU:

ALBTELECOM

Kjo pyetjen për Albtelecom nuk gjendet me vend pasi përvec tij çdo operator tjetër do ti jepte mbështetje të plotë AKEP-it për këtë reduktim të propozuar për sa kohë që shkon në mënyrë ekstreme në favor të tyre. Këto tarifat asnjehere nuk kanë qënë në rregullim nga AKEP; kjo praktikë është e paprecedente; Rekomandimi 2014 nuk e ka në listë; gjithashtu asnje vend nuk e ka rregulluar këtë treg; ky treg tashme është rregulluar dhe normuar nga Rregullorja nr. 35.

Pavarësisht vendimit që do të merret nga AKEP në përfundim të Analizës së tregut, për sa i takon tarifave të propozuara nga AKEP për Tregun me shumicë të aksesit në elementët pasivë të infrastrukturës së rrjeteve në nivel kombëtar, Albtelcom shpreh mos dakortësinë e tij lidhur me:

1) Tarifat e Albtelecom të konsideruara në analizë (janë konsideruar tarifat e papërditësuara)
2) Tarifat benchmark të konsideruara për propozimin e tarifave të Albtelecom

Lidhur me pikën 1), Albtelecom shprehet se AKEP iu eshte referuar tarifave te papërditësuara, për të cilat e ka bërë më dije dokumeti derguar operatorëvë të interesuar. Në këto tarifa Albtelecom ka marrë parsysh: kapacitete e lira; kostot përkatëse të ndërtimit dhe shtirjes së tubacioneve; gjatësinë e tubacionit. Gjithashtu në varësi të kokëzgjatjes, vazhdimësisë së kontratës dhe korrëktësisë, Altelecom mund të aplikojë edhe skonto. Lidhur me Tarifat benchmark të konsideruara, tarifa në të cilat është mbështetur propozimi i AKEP për rishikimin e tarifave të tubacioneve për Albtelecom, analiza e bërë sipas gjykimit të Albtelecom nuk qëndron për një sërë arsyesh që në fakt evidentohen edhe nga vetë AKEP, të tilla si:

a. Niveli i tarifave të propozuara ka diapazon shumë të madh dhe paraqiten mënyra të ndryshme tarifimi në këto vende dhe krahasimi është shumë kompleks.
b. Informacioni për tarifat e propozuara sic edhe citohet në dokument i referohet aksesit në tubacione në pjesën e rrjetit lokal, pra nuk përfshihen tarifat për tuba në rrjet kryesor, ndërkohë që bazuar në këtë informacion propozohen tarifat e Albtelecom për aksesin në tubacione në rrjetin kombëtar. Gjitashtu nuk është marrë parasysh tarifat one off, për procesin e kërkesës dhe planifikimit, të cilat Albtelecom nuk i aplikon.
c. Mosvendosja e detyrimeve simetrike për të gjithë operatorët që disponojnë infrastruktura fizike të komunikimeve elektronike dhe jo vetëm. Bazuat në Direktiven 2014/61/EU, pjëse e ketij detyrimi duhet ët jenë edhe operatorët e gazit, energjisë elektirke, ujit, transportit edhe te tjerë.
d. Mosmarrja në konsideratë e investimeve të Albtelecom prej miliona Euro, investim ky i cili shpesh është cënuar për shkak të dëmtimeve të infrastrukturës së fibrës në rrugë urbane dhe interurbane të cilat Albtelecom i është dashur t'i rekuperojë me shpenzimet e veta, apo pengesave të vazhdueshme dhe zvarritjeve disa vjecare për marrjen e lejeve administrative për finalizimin e shtrirjes së rrjetit backbone etj. I gjithe investimi i tij nuk ka mundur akoma te shfrytezohet dhe gezohet nga vete Albtclecom per sherbimet e tij dhe aq me pak te kthehet investimi i bere. Ndaj dhe, perpos faktit qe smndartet teknike te ndertimit te infrastruktures inter-urbane nuk mundesojne ofrimin e aksesit per palet e treta, nuk mund te pranohet qe i gjithe ky investim te rrezikohet nga aksesi i deryruar me tarifa te paracaktuara qofte edhe ne rrjetin lokal (urban) te Albtelecom.
e. Nga komenti i AKEP lidhur me tarifat e propozuara për aksesin në tubacione, lihet të kuptohet sikur objekti kryesor i AKEP duket se është të rendisë apo pozicionojë tarifat e Albtelecom të aksesit në tubacione midis

tarifave më të ulëta që aplikohen në vendet e BE-së. Ndërkohë objekti kryesor i AKEP duhet të ishtë: ngarkimi i drejtë, proporcional; përcaktimi i tarifave me shumicë duke marrë në konsideratë specifikate telefonisë fikse; kostot e incumbent; investimete vazhdushme; kthimin nga investimi.

Për arsyje të dhëna më sipër Albtelecom gjykon se e vetmja referencë e justifikueshmë mund të jëtë Mesatarja e Përgjithshme e EU-27.
Në përfundim, në çdo rast nuk mund të pranohet detyrimi për kontrollin/rregullimin e tarifave e tubacioneve dhe për më tepër në rrjetin kombëtar pasi një detyrim i tillë do t'i përcaktonte Albtelecom ofrimin e shërbimit me tarifa të paracaktuara që nuk marrin në konsideratë as ndryshimet në koston e ndërtimit të këtyre tubacioneve në rajone të ndryshme, as dëmtimet që për nga informaliteti që karakterizon vendin tonë janë të konsiderueshme dhe as mundësinë fizike të operatorit për të ofruar akses në tubacion në një rajon të caktuar.

i. A përbëjnë tarifat e aksesit në tubacione të vendeve të rajonit një referencë/benchmark më të mirë dhe të arsyshëm për tarifat në Shqipëri?

ALBTELECOM
Tarifat e aksesit në tubacione të vendeve të rajonit, i referohen aksesit në tubacione në pjesën e rrjetit lokal, pra nuk përfshin tarifat për tuba në rrjetet kombëtare interurbane, tarifa të cilat janë propozuar në dokumentin e AKEP për aplikim të detyrushëm nga Albtelecom. Në këto krahasime nuk merret tarasysh tarifa one off, kushte e mirembjatjes dhe investimeve ndryshojne nga ato të vendeve EU dhe rajonit, vonesat në pajisjem me leje gjatë kalimin ne NGN, etj., faktorë këta që bëjnë më të gjatë kthimin nga investimi.

TELEKOM ALBANIA
Duke qënë se vendet e rajonit kanë ngjashmëri më te madhe me Shqiperinë për sa i përket kushteve ekonomike dhe nivelit të zhvillimit ekonomik (në terma të nivelit të çmimeve dhe të të ardhurave për frymë), TA mendon si më të përshtatshme marrjen për referencë/benchmark të këtyre vendeve në lidhje me kwto tarifa.

ii. A mendoni se rregullimi i këtyre tarifave me metodën benchmark është i përshtatshëm apo duhet të përdoren modele të kostove?

ALBTELECOM
Albtelecom rithekson se është kundër vendosjes nën rregullim të Tregut me Shumicë të Aksesit në Elementët Pasivë të Infrastrukturës së Rrjeteve në Nivel Kombëtar, pasi ky treg nuk është pjesë e tregjeve sipas Rregullores për Analizën e Tregjeve dhe Rekomandimit 2014 dhe për më tepër nuk ka as praktikëtë vendeve të EU që tregu i infrastrukturës në nivel kombëtar të rëndohet me detyrime të kësaj natyre sic është propozuar nga AKEP. Për më tepër Albtelecom është kundër cdo rregullimi të tarifave të aksesit në tubacione, për sa kohë që aksesi në tubacione u rregullua dhe u normua me Rregulloren nr.35, datë 10.07.2015. Gjithashtu propozimi i AKEP për rregullimin e tarifave bazuar në benchmarkun e vendeve të rajonit apo të BE-së është i pabazuar dhe nuk merr aspak në konsideratë investimet e Albtelecom dhe kostot në vite të tij për shtrirjen e rrjetit të fibrës optike në gjithë Shqipërinë. Zbatimi i një modeli të kostove përdoret gjerësisht në shërbimet standarte, ndërsa për shërbime specifike gjykimi më i mieë është konsiderimi që vetë Albtelecom ka argumentuar në korenspondencat e tij me AKEP:

1) Shpenzirnet e kryera ne vite per ndertimin e fibres, mirembajtje,amortizimin, ROI etj;
2) Kostot e ndertimit te infrastruktures ne rruget urbane ne kushtet e sotme dhe me ROI 15 vjet.

Bazuar edhe në Rregulloren nr. 35, Albtelecom ka përditësuar rast pas rasti tarifat dhe iu janë bërë më dije operatorëve, duke ofruar edhe diskaunt-e bazuar në kritëret që janë përmendur në komentet e sjella për pyetjet mësipër. Ndaj Albtelecom shprehet kundër reduktimeve deri në 74%.

TELEKOM ALBANIA
Ashtu sic u theksua dhe në komentet e pyetjes së mësipërme, TA mendon se është më e saktë, por duke qënë se rregullimi i tarifave të aksesit në tubacione aplikohet për herë të parë nga ana e AKEP, dhe duke qënë se nuk ka një bazë të sakte informacioni dhe trasparence në lidhje me kostot e ndërtimit të tubacioneve, TA gjykon që fillimisht përdorimi i metodës benchmark për rregullimin e këtyre tarifave është një mënyrë e përshtatshme për rregullimin e tarifave për akses në tubacione.

iii. A mendoni se reduktimi i këtyre tarifave do të sjellë rritje të ndjeshme të përdorimit të tyre dhe rritje të konkurrencës në tregun me pakicë të aksesit broadband?

ALBTELECOM

Albtelecom gjykon se konkurrenca eficiente në tregun e komunikimeve elektronike dhe në vecanti në secilin prej tregjeve respektive nuk mund të arrihet thjesht duke reduktuar tarifat me shumicë dhe duke mbingarkuar vetëm operatorin inkumbent me detyrime rregullatore me qëllimin e vetëm t'ju shërbejë operatorëve të tjerë me tarifa që nuk marrin aspak në konsideratë investimet prej miliona Eurosh, ndërkohë që të ardhurat e Albtelecom vijnë gjithmonë në reduktim. Albtelecom gjykon se kjo ulje e tarifave të aksesit në tubacione të propozuar nga AKEP do të dëmtonte rritjen e konkurrencës në tregun broadband me pakicë, pasi:

- Nga njëra anë, do të bënte totalisht të painteresuar AO për investime qoftë edhe në pjesë të vogla infrastrukturore nga ana e tyre, pasi do të ishin të favorizuar nga tarifat e paracaktuara nga AKEP në nivele drastike të ulëta për Albtelecom;
- Nga ana tjetër, vetë Albtelecom duke u rënduar me detyrime rregullatore dhe duke iu paracaktuar tarifa të ulëta në një treg i cili nuk është as pjesë e tregjeve sipas Rregullores për Analizën e Tregjeve si dhe as nuk është pjesë e Rekomandimit 2014, do të jetë i detyruar të mos synojë më investime që kërkojnë buxhete të mëdha në rrjetin e telekomunikacioneve sa kohë që duket se infrastruktura e ngritur dhe që mund të ngrihet në cdo rast prej tij duhet në cdo rast të përmbushë detyrimet rregullatore në rritje, pa pasur kështu mundësinë e kthimit apo dhe të përfitimit nga investimi i tij. Është ligj i ekonomisë së tregut që në mungesë të përfitimit nga investimi, konsiderimi i mëtejshëm për investime në Telekomunikacion nuk mund të përbëjë më "case" për Albtelecom.

VODAFONE ALBANIA

Për sa i takon aksesit në infrastrukturen pasive (tuba, dark fiber, etj) VA gjykon se duhet të jetë i rregulluar nisur nga karakteristikat qe ka ky treg. VA gjykon se masat rregulluese nuk duhet te fokusohen vetem ne rregullim tariafsh. Tregu backbone nuk duhet rregulluar pasi shfaq shenja konkurence ne nje të ardhme te afert, ai që duhet te jete ne rregullim eshte aksesi lokal. Per aksesin pasiv, VA gjykon se duhet të garantohet e drejta për akses, kurse rregullimi i tarifave mbetet i rëndësisë dytësore.

Qëndrimi i AKEP

AKEP sqaron Albtelecom se, qellimi i rregullimeve te propozuar asnjere nuk ka qene ai i demtimit te operatoreve ne treg dhe aq me teper te demtoje konkurencen, fakt per kete eshte pershtatja e rregullimit sipas rekomandimeve te KE dhe praktikave me te mira me kushte specifike. Gjithashtu nisur edhe nga zhvillimet ne lidhje me bazen ligjore qe sanksionon aksesin në tubacione, e cila eshte zgjeruar me miratimin e ligjit 120/2016 "*Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë dhe sigurimin e së drejtës së kalimit*", si edhe zhvillimet te tjera, AKEP gjykoi dhe vleresoi te marre parasysh shume nga komentet e operatoreve, per nje rregullim sa me eficient te ketyre tregje, te cilet jane faktore kyc dhe te lidhura ngushte me zhvillimin pozitiv te tregjet te tjera me shumice.